



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. E-53/4 Prot.

Tiranë, më 12.05 /2021

URDHËR

Nr. 340, datë 12/05 2021

**“PËR
PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË LICENCËS SI NOTERE, TË NOTERES ENTELA
SHQEPA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të pikës 3, të nenit 18, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Pranë Ministrisë së Drejtësisë është paraqitur shkresa e noteres Entela Shqepa, me lëndë “Kërkesën për pezullim të përkohshëm të licencës së noterisë”, protokolluar pranë nesh me nr.E-155 prot., datë 03.09.2020.

Nëpërmjet kësaj kërkesë znj. Shqepa ka parashtruar faktin se është shtatzanë dhe gjendja e saj shëndetësore është kritike për vazhdimin e kësaj shtatzanie, pasi nga vizitat mjekësore rezulton me “hematome poseriore” dhe rrezik për “abort inician” dhe nga ana e mjekëve i është rekomanduar regjim shtrati absolut. Këtë fakt znj. Shqepa e vërteton me raportet mjekësore të cilat ia ka bashkëlidhur kërkesës. Ndodhur në këto kushte, noterja kërkon pezullimin e përkohshëm të licencës së noterisë.

Duke qenë se, noterja znj. Shqepa në kërkesën që kishte parashtruar për pezullimin e licencës së noterisë, nuk kishte parashikuar periudhën kohore të nevojshme për pezullimin e kësaj licence, si dhe propozimin e një noteri të cilit do t’i kalonte arkiva për sa kohë të jetë e pezulluar licenca, nga ana jonë i është dërguar shkresa me nr. E-155/1 prot., datë 16.11.2020, ku i është kërkuar që të përcaktonte saktë periudhën kohore për pezullimin e licencës, në bazë të pikës “2”, të nenit 18 të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i cili parashikon se, “Kërkesa për pezullimin e përkohshëm të licencës i drejtohet Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës dhe **përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit**”, si dhe të propozonte noterin administrues të arkivës së saj.

Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i cili parashikon se, *“Kërkesa për pezullimin e përkohshëm të licencës i drejtohet Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës dhe përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit”*, si dhe të propozonte noterin administrues të arkivës së saj.

Për këtë arsye, me shkresën kthim përgjigje, datë 20.11.2020, protokolluar nga ana jonë me nr. E-155/2 prot., datë 24.11.2020 noterja Entela Shqepa përcakton që periudha e pezullimit të licencës të jetë nga data 15.12.2020 deri më datë 01.12.2023. Po ashtu, znj. Shqepa propozon caktimin e noteres znj. Ermira Jano, notere në Bashkinë Fier, si notere administruese të arkivës së saj, për periudhën e pezullimit të licencës.

Referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht, në gërmën “b”, të pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, *“Noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet përkohësisht, për arsyet e mëposhtme...b) përkujdesjes për fëmijën e tij të mitur derisa fëmija të mbushë moshën 3-vjeçare”*. Gjithashtu, në paragrafin e dytë të po këtij neni, parashikohet se, *“Për rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, pezullimi zgjat për një periudhë nga 6 muaj deri në 3 vjet*.

Në pikën “3”, të nenit 18, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, *“Ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës. Në rast se kërkesa për pezullim është për një periudhë deri në një vit, Ministri i Drejtësisë mund të caktojë një noter tjetër për të administruar arkivin e noterit të pezulluar, gjatë gjithë periudhës së pezullimit të licencës së këtij noteri. Në rast se kërkesa për pezullim bëhet për një periudhë më shumë se një vit, kur Ministri i Drejtësisë vlerëson se nevojat për shërbime noteriale në bashkinë përkatëse janë të larta dhe nuk mund të mbulohen në mënyrë të përshtatshme nga noteri administrues, vendi i noterit konsiderohet vakant dhe plotësohet menjëherë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj”*.

Ndërkohë, në pikën 1, të nenit 10, të Ligjit nr.110/2018, parashikohet se, *“Numri i përgjithshëm i noterëve që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk mund të jetë më i lartë se numri i përcaktuar nga raporti 1 noter për çdo 15 000 banorë rezidentë, bazuar në të dhënat zyrtare të censusit të fundit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”*. Duke qenë se znj.Shqepa ushtron profesionin e noterit në Bashkinë e Fierit, nuk ndodhemi përpara rastit kur nevojat për shërbime noteriale në bashkinë përkatëse janë të larta dhe nuk mund të mbulohen në mënyrë të përshtatshme nga noteri administrues.

Në vijim,me shkresën nr. E-155/3 Prot., datë 22.02.2021, i jemi drejtuar Dhomës Kombëtare të Noterisë, me qëllim dhënien e mendimit mbi kërkesën e paraqitur nga znj. Entela Shqepa.

Me shkresën nr. E-53/2 Prot., datë 04.05.2021 Dhoma Kombëtare e Noterëve ka vlerësuar se kërkesa e paraqitur duhet pranuar, duke propozuar dhe noterin z. Ardian Karroqe si përfaqësues për kalimin e arkivës noteriale të znj. Entela Shqepa, te notere Ermira Jano.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të pikës 3, të nenit 18, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë",

URDHËROJ:

1. Pezullimin e licencës së ushtrimit të veprimtarisë noteriale, noteres Entela Shqepa për periudhën 15.12.2020 deri më 01.12.2023.
2. Caktimin e noterit i cili do të administrojë arkivën noteriale, deri në përfundim të periudhës së pezullimit të licencës, notere znj. Ermira Jano.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë,
 - b) Noteri z. Ardian Karroqe, anëtar i degës së noterisë Vlorë.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Entela Shqepa, nga Komisioni i caktuar në pikën 3, të këtij urdhri.
5. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit menjëherë pasi të njihet me këtë urdhër, të caktoj datën dhe orën e dorëzimit të arkivit, si dhe të njoftoj noterën znj. Entela Shqepa 5 (pesë) ditë përpara për datën dhe orën e caktuar.
6. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
7. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal të nëshkruar nga anëtarët e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit dhe noterja znj. Entela Shqepa. Brenda 5 ditëve, pas administrimit të arkivës së znj. Entela Shqepa, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës, noterit i cili do të administrojë arkivën noteriale, znj. Ermira Jano.
8. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, noterja znj. Entela Shqepa dhe noterja znj. Ermira Jano.

9. Regjistrimin e këtij Urdhri në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.
11. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

